

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN**

PËR

SHPËRBLIMIN E PENSIONISTËVE PËR FESTAT E FUNDVITIT 2023

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Projektvendimi që paraqitet për shqyrtim ka si qëllim përmirësimin e nivelit të plotësisimit të nevojave të pensionistëve dhe në veçanti nëpërmjet këtij shpërblimi financiar të mbulohet një pjesë e shpenzimeve personale për festat e fundvitit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Projektvendimi është në përputhje me programin ekonomik të Këshillit të Ministrave dhe është i mbështetur në dispozitat ligjore të fushës së shpërblimeve dhe përfitimeve të tjera sociale të miratuara në programin buxhetor të vitit 2023, të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 84/2022 "Për buxhetin e Vitit 2023", i ndryshuar.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Nga shpërblimi i parashikuar në këtë projektvendim do të përfitojnë 704,043 pensionistë dhe përfitues të tjerë nga të cilët mbi 584,583 janë pensionistë në pension pleqërie dhe pension social, 66,080 persona në pension invaliditeti, 44,199 persona në pension familjar dhe mbi 9,181 persona të tjerë që përfitojnë pension të parakohshëm apo trajtim të veçantë financiar si minatorë të nëntokës, pension sipas nenit 5 të Ligjit 29/2019, punonjës të ish - ndërmarrjeve ushtarake dhe përfitues sipas neneve 5, 5/1/a , 5/1/b të Ligjit 7703/1993, i ndryshuar, etj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektvendimi që paraqitet për shqyrtim bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar si dhe Ligjin nr. 84/2022 "Për buxhetin e Vitit 2023",

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE).

Projektvendimi nuk synon përafrimin me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.

Në këtë projektvendim parashikohet dhënia e një shpërblim financiar, në masën 5 000 lekë, personave që përfitojnë pension dhe trajtime të tjera financiare. Konkretisht kategoritë që përfitojnë dhe numri i përfituesve evidentohet më poshtë:

- 584,583 persona, që përfitojnë pension pleqërie dhe pension social, 66,080 persona që përfitojnë pension invaliditeti, 44,199 persona që përfitojnë pension familjar , sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" , sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe sipas Ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë",
- 2,172 persona, që marrin pension sipas Ligjit 150/2014 "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas Ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas Ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar;

- 6,053 persona, që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas Ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- 8 persona që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANC-it, sipas Vendimit nr. 190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e Ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të Ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.
- 20 persona që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm me nenin nr. 5. 5/1/a ose 5/1/b të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- 162 persona që nuk përfitojnë pension nga Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar të caktuar sipas Ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;
- 756 persona, që marrin pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5 të Ligjit 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”
- 10 persona, që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit financiar, si fëmijë në përkujdesje të Republikës, sipas Ligjit nr. 129/2021, “Për statusin fëmijë në përkujdesje të Republikës”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.

Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. si dhe Bankat e Nivelit të Dytë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.

Hartimi i këtij projektvendimi është realizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Projektakti dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë u shpreh dakord me ligjshmërinë e formës dhe përmbajtjes së projektvendimit, duke sugjeruar që të jepen argumentet përkatëse në relacionin shoqëruar për përfshirjen e shpenzimeve administrative në vlerën totale të efektit financiar të këtij projektvendimi, duke pasur në konsideratë se shpërblimi mund të shpërndahet bashkë me pensionin përkatës mujor.

Lidhur me sugjerimin e MD janë dhënë argumente shtesë në seksionin e mëposhtëm të relacionit për pamundësinë e bashkimit të këtyre shpenzimeve në vlerën totale të efektit financiar.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të llogaritura në shumën 3,548,377,000 (tre miliardë e pesëqind e dyzet e tetë milionë e tre qind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë e ndarë në 3,520,215,000 (tre miliardë e pesëqind e njëzet milionë e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për shpërblimin dhe 28,162,000 (njëzet e tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë shpenzime administrative për dhënien e shpërblimit do të përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore të miratuar për Vitin 2023.

Shpërblimet kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin Dhjetor 2023 dhe paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit Dhjetor 2023, ato do të paguhen gjatë vitit të ardhshëm. Në këtë projektvendim përcaktohet se e drejta e tërheqjes së këtij shpërblimi ruhet deri në 31.12.2024. Të drejtën për këtë shpërblim e kanë edhe personat që aktualisht nuk kanë dalë në pension por që e drejta për pension ju lind deri në datën 31.12.2023 përfshirë edhe këtë datë.

Gjithashtu në këtë projektvendim autorizohet ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të bëjnë rialokimin e fondeve, sipas programeve të

buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore deri në kufirin e fondit të parashikuar në këtë projekt vendim.

Në lidhje me përfshirjen e shpenzimeve administrative në vlerën totale të efektit financiar të projektvendimit parashikohet se nuk mund të bashkohen dy natyra të ndryshme shpenzimesh apo as të evitohen pasi:

1. “Efekti financiar i shpërblimit” dhe “shpenzimet administrative” i përkasin llogarive të ndryshme kontabël dhe bashkimi i tyre në të njëjtin zë do të ishte i papërshtatshëm nga ana ligjore, pasi çënohet parimi i moskompensimit të llogarive. Parim ky, i cili respektohet nga të gjitha drejtoritë e financës së çdo institucioni shtetëror dhe privat.
2. Fondet, që shkojnë në institucionet që lëvrojnë pensionet dhe shpërblimet për pensionistët, vijnë nga burime të ndryshme, ku një burim lidhet me pensionin që është rrjedhojë e jetës kontributive të individit dhe tjetri lidhet me shpërblimin që është efekt i politikave qeveritare për mbështetje sociale, kështu që shërbimi i shpërndarjes së tyre realizohet në dy pjesë nga bankat ose posta, për të dyja shumat, në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra, pavarësisht se i jepet pensionistit në total si një shumë e vetme.

MINISTRI

ERVIN METE